



Prishtinë, 15 tetor 2018  
Kodi i ZRRE-së: V\_1046/1\_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Dispozitat e nenit 26 paragrafi 1, nenit 47 dhe nenit 48 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084;
- Dispozitat e nenit 19 të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e nenit 18 dhe nenit 19 të Ligjit për Energjinë Termike Nr. 05/L-052;
- Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike; dhe
- Kërkesën e Ndërmarrjes Publike - Ngrohësja e Qytetit (NQ) Termokos sh.a. të datës 8 korrik 2018, për shqyrtimin e të Hyrave maksimale të lejuara dhe tarifave të energjisë termike, bashkë me dokumentacionin relevant sqarues.

Pas shqyrtimit të shkresave dhe dokumenteve relevante, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, në seancën e mbajtur me datë 15 tetor 2018, nxori këtë:

## VENDIM

- I. **APROVOHEN TË HYRAT MAKSIMALE TË LEJUARA (MAR)** në vlerën **6,619,973 €** për NQ Termokos sh.a. që do të mbledhen nga tarifat e energjisë termike (ngrohjes) për konsumatorët fundorë për sezonin 2018/2019;

## Arsyetim


1. Me datë 8 korrik 2018 Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar kërkesën nga NQ Termokos sh. a. për shqyrtimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara që ndërmarrjes i lejohet të mbledhë nga tarifat e energjisë termike për konsumatorët fundorë.
2. Për përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet dhe shkresat si në vijim:
  - Të dhënat dhe informatat e dorëzuara bashkangjitur me kërkesën për shqyrtimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara, të datës 8 korrik 2018;
  - Komentet me shkrim lëshuar nga ZRRE me 15 gusht 2018, ku janë specifikuar kërkesat për korrigjim, përmirësim dhe plotësim të të dhënave dhe informatave të dorëzuara bashkangjitur me kërkesën e datës 8 korrik 2018;
  - Të dhënat dhe informatat e korrigjuara dhe të plotësuara sipas komenteve me shkrim të ZRRE-së, ri-dorëzuar nga NQ Termokos me datë 22 gusht 2018;



- Raportin për Konsultim Publik: Vlerësimet Preliminare për Përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për NQ Termokos – sezoni i ngrohjes 2018/2019;
  - Komentet me shkrim të pranuar gjatë periudhës së konsultimit publik (10 shtator – 27 shtator 2018);
  - Përgjigjen e ZRRE-së ndaj komenteve me shkrim të pranuar gjatë periudhës së konsultimit publik;
  - Raportin Final për Përcaktimin e të Hyrave Maksimale të Lejuara për NQ Termokos – sezoni i ngrohjes 2018/2019.
3. Duke marr parasysh dispozitat ligjore të cekura në hyrje dhe duke u bazuar në shqyrtimin e të gjitha shkresave dhe dokumenteve relevante, Bordi ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka të drejtë, që të auditojë regjistrat e kontabilitetit dhe faturat e NQ Termokos. për të verifikuar realizimin e të dhënave të paraqitura nga NQ Termokos.
- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të zbatohet nga NQ Termokos nga data 15 tetor 2018 gjer në shqyrtimin e ardhshëm tarifor;
- V. Ky Vendim publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Arsim Janova, U.D. Kryesues

  
Besim Sejfiqaj, Anëtar

  
Selman Hoti, Anëtar

  
Izet Rushiti, Anëtar

**Vendimi ju dërgohet:**

- Palës; dhe
- Arkivit të ZRRE-së